



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 83, datë 20.12.2018

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT  
BUXHETOR AFATMESËM 2020-2022 DHE BUXHETIT VJETOR 2020 TË  
BASHKISË SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja "k", 55 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV", Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",

V E N D O S I:

1. Miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe buxhetit vjetor 2020 të Bashkisë Shkodër, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 20.12.2018

Shpallur në datën 24.12.2018

Sekretar i këshillit

Suel Hadri



KRYETAR

Xhemal BUSHATI

## Lidhja nr.1

# KALENDARI I PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2020-2022 DHE BUXHETIT VJETOR 2020

### Kalendari PBA & buxhetit vjetor

- Përgatitet nga Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe i propozohet më tej Këshillit të njësisë;
- Miratohet nga këshilli njësisë (brenda 31.12. 2018);
- Hyn në fuqi dhe shpërndahet tek të gjitha njësitë shpenzuese nga Kryetari i njësisë (1.01. 2019).

### Vlerësimet dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve

- Kryetari paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill (brenda 31.01.2019);
- Këshilli miraton raportin e vlerësimeve (1.03. 2019).

### Tavanete shpenzimeve të PBA në nivelin e programi

- Kryetari njësisë propozon tavanet përgatitore për miratim në këshill (1.03. 2019);
- Këshilli miraton tavanet përgatitore (15.03. 2019);
- Kryetari njësisë miraton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit (5 ditë nga miratimi i tavanëve);
- Udhëzimi shpërndahet tek njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve / 20.03. 2019);
- Tavanet përfundimtare paraqiten nga Kryetari i njësisë në Këshill (korrik viti 2019);
- Këshilli miraton tavanet përfundimtare (20.07.2019);
- Kryetari i njësisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve përfundimtare / 25.07. 2019).

### Kërkesat sipas tavanëve

- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përgatitore tek Njësia e Menaxhimit të Programeve (Prill viti t) dhe japin argumenta për fonde / tavanë shtesë;
- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përfundimtare (1.08. 2019).

PBA&Buxheti  
vjetor

- Kryetari i njësisë përgatit dokumentin e I-rë të PBA viti 2020-2022 (30.05. 2019);
- Kryetari njësisë dërgon MFE PBA (1.06. 2019);
- MFE dërgon opinionion e saj mbi PBA tek njësia vendore(20.06. 2019);
- Kryetari njësisë vendore dërgon PBA së bashku me opinion e MFE për miratim në Këshill (21.06. 2019);
- Këshilli i njësisë vendore miraton dokumentin e parë të PBA (30.06. 2119);
- Kryetari publikon PBA / dokumentin I-rë (5.07.2019);
- MFE nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA (10. Korrik 2019);
- Njësia rishikon PBA (Korrik - Gusht 2019);
- Njësia organizon takime konsultuese (1-15.09. 2019);
- Njësia dërgon PBA e rishikuar tek MFE (15.09.2019);
- MFE zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore (5.10.2019);
- MFE dërgon opionin përfundimtar sipas rastit tek njësia vendore(20.10.2019);
- Kryetari bashkisë paraqet për miratim në Këshill PBA dhe buxhetin vjetor përfundimtar (30.11.2019);
- Këshilli miraton PBA dhe Buxhetin vjetor (25.12.2019);
- Kryetari njësisë publikon PBA dhe buxhetin vjetor & materialet shoqëruese (31.12.2019).

Snel Heshu



Abdullahu Busbati





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1463/1 prot.

Shkodër, më 07.01.2019

**LËNDA: Mbi me vendimin nr. 83, datë 20.12.2018 të Këshillit Shkodër**

**KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin”, neni 8, gërma a, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, neni 56, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 41, neni 54, pika k, neni 55 pika 2, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33, të ligjit nr. 9963, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23., dt. 30.07.2018 “Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, dt. 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, shqyrtoi **VKB Shkodër nr. 83, datë 20.12.2018 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së së programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe buxhetit vjetor 2020 të Bashkisë Shkodër”.**

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Me respekt,

**P R E F E K T I**

Çesk MILLJA



VENDIME, UDHEZIME, SHKRESA, KERKESA  
NR. 300 DATE 05.01.2019  
DERGHAR TGA:  
LËNDA: . . . . .

POSIA E TITULLARIT: